



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË  
FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT  
TË UJËRAVE TË NDOTURA  
KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR**

**VENDIM**

**Nr. 67, datë 06.09.2018**

**PËR LICENCIMIN E SH. A. UJËSJELLËS KANALIZIME DROPULL**

Në zbatim të nenit 14, pika 1/a, nenit 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", VKM nr. 958, datë 06.05.2009 "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence", si dhe Rregullores së licencimit miratuar me vendim të KKRR nr. 29 datë 08.12.2009 "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", e ndryshuar dhe pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria Teknike Ekonomike, mbi aplikimin e shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Dropull sh.a për licencim për herë të parë, Komisioni Kombëtar Rregullator,

**Konstatohet se:**

- Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Dropull sh.a ka aplikuar pranë ERRU për licencim për herë të parë me shkresën me nr. 39 prot. të datës 13.06.2018 për ofrimin e shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura;
- Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Dropull sh.a është themeluar më datë 21.12.2017 si shoqëri aksionere me një nivel administrimi në pronësi të Bashkisë Dropull, në përputhje me parashikimet e VKM nr. 63, datë 27.1.2016 "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura". Kjo shoqëri është regjistruar në QKB në datën 16.02.2018 me NUIS L82616601E;
- Në dosjen e aplikimit mungonte dokumenti i ekstraktit të regjistrimit tregtar për të dhënat e subjektit shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Dropull si dhe Akti i miratimit Higjieno-Sanitar si dhe pagesa për licencim për dy kategoritë e kërkuara. Dosja u plotësua më datë 27.07.2018.
- Aplikimi i shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Dropull sh.a plotëson kërkesat e parashikuara në Rregulloren e Licencimit për licencim për herë të parë, konkretisht:

- Formati i aplikimit është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni juridik dhe administrativ është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator,

**VENDOSI:**

1. Licencimin e operatorit Ujësuellës Kanalizime Dropull sh.a me:

Drejtues Ligjor Alqi Kazazi

Drejtues Teknik Gaqe Meçi

2. Operatori sh.a. Ujësuellës Kanalizime Dropull autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategorinë:

Kategoria A, për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;

Kategoria C, për largimin e ujërave të ndotura;

3. Zona e shërbimit të këtij operatori është Bashkia Dropull.
4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4 (katër) vjeçare.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

**K R Y E T A R I**

**Ndriçim SHANI**